



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 4664 Prot

Shkodër, më 26.02.2025

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim:

**PËR**

**“STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. G.T DHE FËMIJËVE TË MITUR NË NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS VETERINARE )”**

*Duke Ju uruar punë të mbarë!*

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI  
ZV/KRYETAR  
Onid BEJLERI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR

4664/  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më 26.02.2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2025

PËR

“STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. G.T DHE FËMIJËVE TË MITUR NË NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS VETERINARE)”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 2, pika 25 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, i ndryshuar; pikës 19 të VKM - së nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore; VKB nr. 24 datë 10.5.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës “Veterinare” dhe të “Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër”; VKB nr.21 datë 29.04.2024 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër”; Vendimit nr.36 (481), datë 11.02.2025 “Për Lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes”, së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër me nr. \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_\_\_,

VENDOSI:

1. Të miratojë strehimin emergjent të zj. G.T dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira (ish-Konvikti i Shkollës Veterinare)”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**


**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI  
ZV/KRYETAR  
Onid BEJLERI**


Zv/Kryetar



Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik



Drejtorja e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore  
dhe Shërbimeve Mbështetëse



Drejtorja Juridike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT DHE SHËNDETIT  
PUBLIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025

### RELACION

**“PËR STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. G.T DHE FËMIJËVE TË MITUR NË NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS VETERINARE )”**

### KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Me datë 11.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me Vendimit nr.36 (481), datë 11.02.2025 “Për Lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes”, në pikën 2 të vendimit, ka vendosur:

- Lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes të paditëses G.T (së bashku me fëmijët e saj të mitur).

Nga sa më sipër, në zbatim të pikës 19 të VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, në të gjitha situatat e gjendjes së emergjencës, kur procedura fillon me kërkesë të individit/familjes përfituese, ose kryesisht nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, emri/at/ lista e aplikantëve paraqitet/n menjëherë në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për miratim.

Duke qenë në kushtet e nevojës emergjente për strehim, propozojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak strehimi emergjent i zj.G.T me fëmijët e saj, në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira (ish-Konvikti i Shkollës Veterinare).

Rasti i G.T. është referuar nga Strehëza Emergjente pasi zonja ishte paraqitur në Komisaratin e Policisë për të bërë kallëzim për veprën penale “Dhunë në familje” dhe ka kërkuar të pajset me Urdhër të Mbrojtjes së Menjehershme.

Akomodimi në strehëzën emergjente është realizuar sipas procedurave të parashikuara, duke siguruar një ambient të sigurt për znj. **G. T** dhe **katër fëmijët e saj të mitur**. Gjatë hyrjes në qendër, janë kryer të gjitha vlerësimet fillestare psikologjike dhe sociale. Janë mbajtur 3 mbledhje ETN-je (ekipi teknik ndërdisiplinor) për menaxhimin e rastit dhe gjetjen e zgjidhjes më të mirë të mundshme, për shkak të nivelit të rrezikut të lartë që ka. Pas shqyrtimit të transferimit të saj në strehëza afatgjatë, ka rezultuar e pamundur realizimi i këtij akomodimi për shkak të mungesës së kapacitetit të strehëzave afatgjata si: Papa Xhovani, Vatra dhe Strehëza kombëtare. Gjithashtu, akomodimi në një shtëpi me qera, për shkak të kushteve specifike të rastit, nuk është konsideruar si zgjidhja më e përshtatshme e rastit. Në këto kushte, në kuadër të interesit më të lartë të fëmijëve dhe zonjës është konsideruar akomodimi në banesë sociale.

Në kuadër të menaxhimit të rastit, janë kryer hapat e mëposhtëm nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik:

- Vlerësim fillestar, përgatitje e PIM dhe vlerësim i nevojave të familjes dhe të miturve;
- Informim mbi shërbimet që mund të përfitojë pranë Bashkisë Shkodër;
- Referim për aplikim tek programet e strehimit pranë Bashkisë Shkodër;
- Referuar dhe mbështetur me dt.20.02.2025 nga organizata “CATAR” me pako ushqimore.
- Ndërmjetësuar pranë çerdhe dhe kopsht “Xixëllonjat” për shërbimet mbështetje me kopësht, çerdhe për fëmijët e mitur, përfshirje në aktivitetet e qendrës Xixëllonjat dhe programin e pashkollorit për vajzën që frekuenton shkollën.
- Mbështetja nga organizatat partnere si: “Të Ndryshëm të Barabartë”, “Shpresë për Botën”, “Hapa të Lehtë” dhe “Gruaja tek Gruaja”, “Kisha Ungjillore”, “The Door” për të gjitha shërbimet që ato ofrojnë dhe sigurimin e kushteve optimale për jetesë.

Në ditët në vijim, do të ofrohet mbështetje e specializuar për stabilizimin emocional dhe për hartimin e një plani të mëtejshëm të rehabilitimit dhe fuqizimit social për të dhe fëmijët e saj.

Duke qenë në kushtet e nevojës emergjente për strehim, propozojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak strehimi emergjent i zj.G.T me fëmijët e saj, në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira (ish-Konvikti i Shkollës Veterinare).

Ju ftojme të miratoni projekt-vendimin “ Të miratojë strehimin emergjent të zj. G.T dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira (ish-Konvikti i Shkollës Veterinare)”.


Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI  
ZV/KRYETAR**

**Onid Bejleri**



Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik

**Arlinda KRUJA**

